



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor

Nr : 04-353/01-116212

Data: 24.09.2024

P r i z r e n

DREJTORIA PËR URBANIZËM DHE PLANIFIKIM HAPËSIROR KK – PRIZREN, me kërkesën e **Osman Qereti** nga Prizreni, me të cilën ka kërkuar leje për „Vendosjen e Paneleve Solare fotovoltaike në objektin afarist” vendosja do të bëhet në kulmin e objektit afarist me numër **O-71813023-207-0**, e cila gjendet në kuadër të ngastrës katastrale **P-71813023-00646-3 Zk.Dushanovë**, në bazë të nenit 3 paragrafit 1, pika 1.27 te Ligjit për Planifikimit Hapësinor me Numër 04/L-174 të datës 31. 07. 2013, neni 3 parografi 1pika 1.1, 1.4, 1.17, 1.24, si dhe nenit 5, paragrafit 1.1 e lidhur me nenin 14 parografi 1 pika 1.1 nenit 15 parografi 1 pika 1.1 të Ligjit për Ndërtim numër 04/L-110, dhe sipas Vendimit për miratimin e Hartës Zonale të Komunës së Prizrenit (HZK) për periudhën 2022 – 2030 – Numër 001-011-48192 të datës 31. 03. 2022 si dhe konform nenit 85 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 44, 46, 47, 48 si dhe nenit 125 të L.P.P.A numër 05/031 të datës 25. 05. 2016 merr këtë:

A K T V E N D I M

I LEJOHET: **Osman Qereti** nga Prizreni, me të cilën ka kërkuar leje për „Vendosjen e Paneleve Solare fotovoltaike në objektin afarist” vendosja do të bëhet në kulmin e objektit afarist me numër **O-71813023-207-0**, e cila gjendet në kuadër të ngastrës katastrale **P-71813023-00646-3 Zk.Dushanovë**.

I. Dokumentacioni teknik-Projekti (projektuesi) SolarKos SH.P.K. me seli në rrugën Tringa Smajli, Nr. 29 Prishtinë.

II. Datën e fillimit të punimeve investitori është i obliguar që të lajmërojë inspepcionin komunal në afat prej 8 ditësh.

III. Vendosja e rrjetit të bëhet simpas dokumentacioni teknik..

- Investitori është i obliguar që punimet të kryen në bazë të dokumentacioni teknik-projektit e në pajtim me normat ndërtimore dhe rregullave të përkohshme teknike për kësi llojë punime:
- **Sipas Pëlqimit Elektroenergjetik dhe Zgjidhjes Teknike të KEDS-it Nr. 12498 të datës 06. 09. 2024.**

IV. Investitori është i obliguar që punimet rreth infrastruktures termike të kryen sipas Aktvendimit të dhëna, kurse vend punimi natën të ndriqohet me dritë ashtu që të mundësohet qarkullimi i lirë i automjeteve dhe të këmbësorëve, kurse materialet të tjera duhet të menjanojen nga rruga ku janë kryer punimet.

V. Ky aktvendim pushon të vlefjë në rastë se me punë nuk fillohet mbrenda afatit prej 12(dymbdhjetë) muajsh, duke llogaritur nga dita e marjes së të njejtës

VI. Pas kryerjes së punimeve Investitori është i obliguar që vendin menjëherë të bjerë në gjendje të mëparshme dhe cdo demtim obligimi mbetet i investitorrit.

VII. Pas përfundimit të ndërtimit investitori duhet të parashtrojë kërkesën për pranimin teknik dhe marrjen e lejes për shfrytëzim.

VIII. Në qoftëse punimet në infrastrukturë nuk mund të kryen në afatin e lejuar, Investitori është i obliguar që të kërkoj nga ky organ leje për vazhdimin e afatit të punimeve.

IX. Ky aktvendim pushon të vlejë në rastë se me punë nuk fillohet mbrenda afatit prej 12(dymbdhjetë) muajsh, duke llogaritur nga dita e marrjes së të njejtës

A r s y e t i m

Osman Qereti nga Prizreni, me të cilën ka kërkuar leje për „**Vendosjen e Paneleve Solare fotovoltaike në objektin afarist**” vendosja do të bëhet në kulmin e objektit afarist me numër **O-71813023-207-0**, e cila gjendet në kuadër të ngastrës katastrale **P-71813023-00646-3 Zk.Dushanovë**.

Duke shqyrtuar kërkesën e Investitorit si dhe dokumentacionit teknik dhe të shtojcave tjera të prezantuara s'bashku me kërkesë vërtetohet se:

Në procedurën paraprake është kontrolluar dokumentacioni teknik nga ana e bashkëpunëtorit profesional.

Në kuptim të dispozitave të lartë theksuara është konstatuar se janë plotësuar kushtet për dhëni e lejes për: „**Vendosjen e Paneleve Solare fotovoltaike në objektin afarist**”.

Nga se u tha më lartë uvendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes së të njejtës Ministrisë së Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor-Prishtinë.



Ankesa taksohet me 0,50 Euro taksa administrative.

Bashkëpunëtor profesional:



Gazmend Berisha, Msc.ndërt.

D R E J T O R I :



Pranverim Berisha, jur. dip.